Nr. 63. Prot
Dat 13.05.2022


Sherife Hoxha
Auditues Ligjor
Rr. Islam Alla, P.51/9, Tirane
License nr. 338

Enkelejda Alite
Auditues Ligjor
Rr. Abdi Toptani,Torre Drin, Zyra 19 Tirane
License nr.309


**Qendra Sportive sh.a**

***RAPORT I AUDITUESVE LIGJORË***

**Për Pasqyrat Financiare**

**(për periudhën nga 1 janar deri më 31 dhjetor 2021)**

PËRMBAJTJA


| | FAQE |
|---|---|
| RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR | 3-5 |
| PASQYRAT FINANCIARE: | |
| PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR | 6 |
| PASQYRA E PERFORMACES | 7 |
| PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL | 9 |
| PASQYRA E FLUKSEVE TË PARASË | 9 |
| SHËNIME SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE | 10 – 21 |

## RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

**Drejtuar: Aksionerit të Vetëm të shoqërisë "Qendra Sportive" sh.a.**
**Rr.Dritan Hoxha, Pallati i Sportit Asllan Rusi, Tiranë**

### Opinioni me Rezervë

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë "Qendra Sportive" sh.a., të cilat përfshijnë Pasqyrën e Pozicionit Financiar më datën 31 Dhjetor 2021, Pasqyrën e të Ardhurave gjithpërfshirëse, Pasqyrën e Ndryshimëve në Kapital dhe Pasqyrën e Fluksëve të Parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, me përjashtim të efekteve të çështjeve të përshkruara në seksionin e Bazës për Opinion me Rezervë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale pozicionin financiar të Shoqerise "Qendra Sportive" sh.a. më 31 dhjetor 2021, përformancen financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara.(SKK).

### Baza për Opinionin me Rezervë

1. Sic është paraqitur në pasqyrat financiare të mbyllura më 31.12.2021, pozicioni financiar "*Të drejta të arkëtueshme nga aktiviteti i shfrytëzimit,*" rezulton në shumën 17,632 mijë lekë deri më 31 Dhjetor 2021 [2020: 17,748 mijë lekë]. Nga kjo vlerë 14 227 mijë lekë janë klientë detyrimi i të cilëve është krijuar para vitit 2012, dhe 974 mijë lekë janë klientë pa listë analitike. Ne nuk mundëm të merrnim konfirmime nga palët e treta në lidhje me plotësinë dhe saktësinë e kësaj shume. Për rrjedhojë ne nuk jemi në gjendje të vlerësojmë efektin e ndonjë korigjimi të mundshëm të pasqyrave financiare të shoqërisë të mbyllura më 31 dhjetor 2021.
2. Sic është paraqitur në pasqyrat financiare të mbyllura më 31.12.2021, pozicioni financiar "*Provizione*", rezulton në shumën 15,195 mijë lekë deri më 31 Dhjetor 2021 [2020: 12,458 mijë lekë]. Nuk ka asnjë process gjyqësor për ndjekjen e klientëvë të paarkëtuar ndër vite.
3. Shoqëria nuk ka një program informatik për mbajtjen e kontabilitetit. Transaksionet kontabël mbahen ne excel gjë që rrit rrezikun për gabime materiale
4. Shoqëria rezulton me humbje prej 10,799 mijë lekë, gjë që cënon parimin e vijimësisë. Të ardhurat e shoqërisë janë të pamjaftueshme për të mbuluar shpenzimet.

### Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, dhe për kontrollin e brendshëm i cili, në masën që përcaktohet nga Drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve.
Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likuidojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetin, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

**Përgjegjësia e Audituesit**

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arësyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arësyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, indiviualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.
Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar mbi auditimin tonë. Ne kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin me qëllim që të përfitojmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk kanë pasaktësi materiale.Auditimi përfshin kryerjen e proçedurave për të marrë evidencë auditimi për shumat dhe informacionet e paraqitura në pasqyrat financiare. Proçedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, përfshirë dhe vlerësimin e rrezikut për pasaktësi materiale në pasqyrat financiare, si rezultat i mashtrimit apo gabimeve. Në bërjen e këtyre vlerësimeve mbi rrezikun, auditori :

- Identifikon dhe vlerëson rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, planifikon dhe kryen procedurat përkatëse të auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, si dhe merr evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin e tij.

- Siguron njohje të kontrolleve të brendshme të aplikueshme për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të përshtatshme sipas rrethanave , por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të Shoqërisë.

-Vlerëson përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe te cmuarjeve kontabël të kryera , si dhe të shënimeve shpjeguese përkatëse të hartuara nga Drejtimi.

-Shprehet në lidhje me parimin e vijimësisë bazuar në evidencat e siguruara gjatë auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston dhe që mund të shkaktojë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Në rast se arrihet në përfundimin që një pasiguri materiale ekziston, audituesi është i detyruar të shprehet në raportin e auditimit me referencë në shënimin shpjegues përkatës , ose nëse shënimet shpjeguese janë të papërshtatshme , të modifikojë opinionin e tij për pasqyrat financiare.

Gjatë auditimit auditori komunikon me personat përgjegjës të ngarkuar për drejtimin e Shoqërisë, dhe i bën të ditur Drejtimit përvecse cështjeve të tjera edhe qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet kryesore të auditimit.Ne besojmë se evidencat e auditimit që kemi marrë ofrojnë baza të arsyeshme për dhënien e opinionit tonë të auditimit.

**Tiranë, më datë 13 Maj 2022**

**Sherife HOXHA**

**Auditues Ligjor**

EKSPERTE KONTABEL I REGJISTRUAR
Sherife Hoxha
Çertifikata Nr.338 Tirane

**Enkelejda ALITE**

**Auditues Ligjor**

ENKELEJDA ALITE
EKSPERTE KONTABËL E REGJISTRUAR
Nipt : L 01606037 A
TIRANE - ALBANIA

**QENDRA SPORTIVE SH.A.**

**Pasqyra e pozicionit financiar për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021**

*(Shumat janë të shprehura në LEK)*

| *Aktivet* | Viti 2021 | Viti 2020 | Vi |
|---|---|---|---|
| Aktive Afatshkurtra | | | |
| Mjetet monetare | 4,834,694 | 7,520,128 | |
| Te drejta te arketueshme | 21,097,658 | 21,213,365 | : |
| Inventare | 348,403 | 373,504 | |
| Shpenzime te shtyra | 0,00 | 0,00 | |
| **Totali i Aktiveve Afatshkurtra** | **26,280,755** | **29,106,997** | : |
| Aktivet Afatgjata | | | |
| Toka | 515,124,090 | 515,124,090 | 51 |
| Ndertesa | 81,574,811 | 83,239,603 | ! |
| Impiante dhe makineri | 844,123 | 1,060,842 | |
| Mjete transporti | 320,159 | 400,199 | |
| **Totali Aktiveve Afatgjata** | **597,863,183** | **599,824,733** | 6( |
| ***Totali i Aktiveve*** | **624,143,938** | **628,931,730** | 6. |
| ***Detyrimet*** | | | |
| Detyrimet Afatshkurtra | | | |
| Te pagueshme nga aktiviteti shfrytezimit | 1,105,638 | 2,285,336 | |
| Te ardhura te shtyra 0 | 0 | 0 | |
| Provizione | 15,194,890 | 12,458,390 | |
| Totali i Detyrimeve Afatshkurtra | **16,300,530** | **14,743,728** | |
| Detyrimet Afatgjata | | | |
| Detyrimet afatgjata | 31,737,453 | 27,283,901 | |
| Te pagueshme per shpz. te konstatuara | 0,00 | 0,00 | |
| Te ardhura te shtyra | 257,100 | 255,300 | |
| Te tjera te pagueshme (hua bashkia Tirane) | 9.922,273 | 9,922,273 | |
| Totali I Detyrimeve afatgjata | **41,916,826** | **37,461,475** | |
| Kapitalet e veta | | | |
| Kapitali i nenshkruar | 635,276,000 | 635,276,000 | 6 |
| Rezerva ligjore | | | |
| Rezerva statutore | | | |
| Rezerva te tjera | 8,579;064 | 8,579,064 | |
| Fitime/Humbje te mbartura | (67,128,537) | (55,251,464) | (1 |
| Fitime dhe Humbje te ushtrimit | (10,799,944) | (11,877,074) | ( |
| Totali i Kapitaleve te veta | **565,926,583** | **576,726,527** | 6 |
| ***Totali i Pasiveve*** | **624,143,938** | **628,931,730** | 6 |

Bilanci kontabël duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 9 deri në 21 që janë pjesë përbërëse pasqyrave financiare.

**QENDRA SPORTIVE SH.A.**
**Pasqyra e performancës për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021**
*(Shumat janë të shprehura në LEK)*

| ***Te ardhurat*** | **Viti 2021** | **Viti 2020** |
|---|---|---|
| Nga Veprimtaria | | |
| Nga aktiviteti shfrytezimit | 12,679,603 | 11,360,571 |
| Te ardhura te tjera nga grantet | 141,140 | 4,961 |
| ***Totali i Ardhurave*** | **12,820,743** | **11,365,532** |
| Shpenzime te veprimtarise | | |
| Lende e pare dhe materiale | -25,101 | -28,686 |
| Paga dhe shperblime | 9,824,073 | 7,665,467 |
| Shpenzime te tjera shfrytezimi | 11,809,963 | 13,534,213 |
| Shpenzime amortizimi | 1,961,155 | 2,071,611 |
| Totali i Shpenzimeve | **23,620,687** | **23,242,605** |
| **Fitimi nga veprimtaria e shfrytezimit** | **(10,799,944)** | **(11,897,209)** |
| Te Ardhurat dhe Shpenzime financiare | | |
| Te ardhura dhe shpenzime nga interesat | | |
| Fitime -humbje nga kembimi | | |
| Te ardhura dhe shp. te tjera financiare | - | - |
| Totali i te Ardhurave dheShpenzimeve financiare | - | - |
| Fitimi/humbja para tatimit | (10,799,944) | (11,897,209) |
| **Shtohen shpenzimet e panjohura** | **2,756,500** | **5,129,988** |
| Provizione | 2,756,500 | 5,129,591 |
| Kamatvonesa | 30,000 | 397 |
| Te tjera | 0,00 | 0.00 |
| Gjoba | 0,00 | 0,00 |
| Fitim/humbje e tatueshme | **(8,033,444)** | **(6,747,086)** |

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 9 deri në 21 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

| | Kapitali aksionar | Rezerva te ligjore | Rezerva te tjera | Fitimi I mbartur | Totali |
|---|---|---|---|---|---|
| **Më 31 dhjetor 2019** | **635,276,000** | **813,717** | **7,765,347** | **(55,251,464)** | **588,603,601** |
| Rritje në kapitalin aksionar | - | - | - | - | - |
| Kaluar në rezerva ligjore | | | | | |
| Pagese dividenti | - | - | | | - |
| Fitimi i vitit | - | - | - | (11,877,074) | (11,877,074) |
| **Më 31 dhjetor 2020** | **635,276,000** | **813,717** | **7,765,347** | **(67,128,537)** | **576,726,527** |
| Rritje në kapitalin aksionar | - | - | - | - | - |
| Kaluar në rezerva ligjore | - | - | - | - | - |
| Pagesë dividendi | - | - | - | - | - |
| Fitimi i vitit | - | - | - | (10,799,944) | (10,799,944) |
| **Më 31 dhjetor 2021** | **635,276,000** | **813,717** | **7,765,347** | **(77,928,481)** | **565,926,583** |

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 9 deri në 21 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

| | Viti 2021 | Viti 2020 |
|---|---|---|
| **Aktivitetet Operative** | | |
| Fitim / Humbja e vitit | (10,799,944) | (11,877,074,) |
| Amortizimi dhe zhvleresimi (dif konvert) | 1,961,551 | 2,071,611 |
| (Rritja)/ Ulja e inventareve | 115,707 | 107,550 |
| (Rritja) / Ulja e kerkesave te arketueshme | 1,961,551 | 2,071,611 |
| (Rritja) / Ulja e inventareve | -25,101 | -28,685 |
| Rritja ( Ulja) e detyrimeve | 6,012,152 | 10,260,301 |
| Rritja / (Ulja) e detyrimeve te tjera afatgjata | | 0,00 |
| Rritja ulja e kapitalit aksionar te papaguar | | 0,00 |
| Fluksi nga veprimtaria e shfrytezimit | 2,685,433 | 533,703 |
| **Aktivitetet e Investimeve** | | |
| Blerje e aktiveve te qendrueshme te trupezuara | | 0,00 |
| Shitje e aktiveve te qendrueshme te trupezuara | 0.00 | 0.00 |
| Fluksi i parase nga Investimet | 0.00 | 0.00 |
| **Aktivitetet financiare** | | |
| Rritja e kapitalit ne para | 0.00 | 0.00 |
| Te Ardhura nga huamarrje | 0.00 | 0.00 |
| Pagesat e detyrimeve te qerase financiare | 0.00 | 0.00 |
| Pagesa e divideteve | 0.00 | 0.00 |
| Fluksi i parase nga aktiviteti financiar | 0.00 | 0,00 |
| Fluksi i parase (rritja) | 2,685,433 | 533,705 |
| Cash dhe Banka ne fillim te periudhes | 7,520,128 | 6,986,424 |
| Cash dhe Banka ne fund te periudhes | 4,834,694 | 7,520,127 |

Pasqyra e fluksit të parasë duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 9 deri në 21 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

*(Shumat janë të shprehura në LEK, përveçse ku shprehet ndryshe)*

# 1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Shoqeria Qendra Sportive sh.a. eshte regjistruar ne daten 01/03/1996 me NIPT :J61813020F me aktivitet kryesor :organizimin dhe zhvillimin e ndeshjeve kombetare dhe nderkombetare, realizimin e te ardhurave nga keto aktivitete, mirembajtje dhe administrim i objekteve sportive.
Selia e shoqerise ndodhet ne adresen :Rruga Dritan Hoxha, Pallati Sportit Asllan Rusi, Tirane.

# 2. BAZAT E PËRGATITJES

## 2.1 Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK). Bazuar në SKK 11 "Tatim Fitimi", paragrafi 4, Shoqëria ka zgjedhur të mos regjistrojë tatim të shtyrë në pasqyrat e veta financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021.

## 2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike. Këto pasqyra financiare janë përgatitur dhe prezantuar në Lek Shqiptar "LEK".

## 2.3 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtuesit të ushtrojnë gjykimin, vlerësimin dhe supozimet që ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël dhe në shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati faktik mund të ndryshojë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken.

Në veçanti, informacioni mbi fushat më të rëndësishme të pasigurisë së vlerësimeve dhe gjykimeve kritike në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efekt më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare duke patur parasysh thjeshtësinë kontabël të veprimeve të realizuara nga Shoqëria.

# 3. POLITIKAT KONTABËL

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

## 3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

*(Shumat janë të shprehura në LEK, përveçse ku shprehet ndryshe)*

Kurset zyrtare të aplikueshme nga Banka e Shqipërisë për këmbimin e LEK-ut me USD dhe Euro më 31 dhjetor 2020 dhe 2021 janë si më poshtë:

| | **31 dhjetor 2021** | **31 dhjetor 2020** |
|---|---|---|
| US Dollar (USD) | 106,54 | 100,84 |
| Euro (EUR) | 120.76 | 123.70 |

## 3.2 Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre, llogari të arkëtueshme, llogari tregtare të pagueshme dhe llogari të tjera të pagueshme.
Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to (për instrumentat jo të mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes), përveç siç përshkruhet më poshtë.

*Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre*

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat afatshkurtra me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së rrjedhës së parasë, mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përfshijnë depozita të pakushtëzuara me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit. Rakordimi i totalit të mjeteve monetare në arkë dhe në bankë me mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre është paraqitur në shënimin 4.

*Llogari të arkëtueshme*

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provigjoni për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna objektive se Shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar dhe vonesat në pagesa konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme duhet të zhvlerësohen. Shuma e provigjonit llogaritet si diferencë midis vlerës kontabël (neto) të aktivit dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

*Llogari të pagueshme*

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë në njohjen fillestare dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

### 3.3 Aktive afatgjata materiale

*i. Njohja dhe matja*

Aktivet afatgjata materiale maten me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi. Kostot përfshijnë shpenzimet që janë të lidhura direkt me blerjen e aktivit. Kur pjesë të një aktivi afatgjatë materal kanë jetë të dobishme të ndryshme, ato llogariten si zëra të ndara (pjesë të rëndësishme) të aktiveve afatgjata materiale.

*ii. Kostot vijuese*

Kostoja e zëvendësimit të aktive afatgjata materiale është njohur në vlerën kontabël (neto) të pjesës në qoftë se është e mundur që në të ardhmen të mirat ekonomike të përfshira në atë pjesë do t'i vijnë Shoqërisë dhe kostoja mund të matet me besueshmëri. Kostot e shërbimeve të përditshme të aktiveve afatgjata materiale janë të njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur ndodhin.

*iii. Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve afatgjata materiale është llogaritur duke u mbështetur mbi jetën e dobishme të çdo pjese të një zëri duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes.
Toka nuk amortizohet. Të gjitha aktivet e tjera amortizohen me metodën e vlerës së mbetur.

Metodat e amortizimit, jetët e dobishme dhe vlera e mbetur e pronave, pajsjeve dhe makinerive janë rishikuar në datën e raportimit.

*(Shumat janë të shprehura në LEK, përveçse ku shprehet ndryshe)*

## 3. POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

### 3.4 Aktive afatgjata materiale(vazhdim)

*iii. Amortizimi (vazhdim)*

Metodat e amortizimit dhe norma e amortizimit për periudhën aktuale dhe atë krahasuese janë si vijon:

| Kategoria e aktivit | Metoda e amortizimit | Norma e amortizimit |
|---|---|---|
| Toka | | 0% |
| Ndertesa | Mbi vlerën kontabël neto | 5% |
| Makineri dhe paisje | Mbi vlerën kontabël neto | 20% |
| Mjete transporti | Mbi vlerën kontabël neto | 20% |
| Paisjet informatike | Mbi vlerën kontabël neto | 25% |

### 3.5 Provizonet

Provigjoni është një detyrim aktual, për të cilin koha e shlyerjes ose shuma janë të pasigurta.
Për njohjen e provigjoneve në bilanc, për përcaktimin e shumës së nevojshme për shlyerjen e provigjoneve ose afatit kohor të provigjoneve, do të merret për bazë opinioni i drejtuesve ose ekspertëve të tjerë.. Në çdo datë të bilancit, drejtuesit e njësisë ekonomike vlerësojnë domosdoshmërinë për krijimin e provizioneve të reja dhe rivlerësimin ose anulimin e provizioneve ekzistuese.

### 3.6 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në përputhje me SKK 8 Të ardhurat.
Të ardhurat nga shitja njihen kur janë plotësuar të gjitha kushtet e mëposhtme:

- Shoqëria ia ka kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet që lidhen me pronësinë e mallrave apo te sherbimeve;
- Shuma e të ardhurave mund të matet me besueshmëri;
- Është e mundur që përfitimet ekonomike që lidhen me transaksionin do të merren nga njësia ekonomike; dhe
- Shpenzimet e bëra ose që do të bëhen në lidhje me transaksionin mund të maten me besueshmëri.

### 3.7 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesat për llogaritë rrjedhëse në bankë dhe fitimet nga kurset e këmbimit. Të ardhurat nga interesat njihen kur realizohen duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet financiare përfshijnë interesat nga huamarrjet dhe humbjet nga kurset e këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes (nëse ka). Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

### 3.8 Shpenzimet e tatimit mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës i cili njihet drejtpërdrejt në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm për t'u paguar mbi të ardhurat e tatueshme të vitit, duke përdorur normat tatimore të miratuara gjatë periudhës.

*(Shumat janë të shprehura në LEK, përveçse ku shprehet ndryshe)*

## 4. MJETE MONETARE DHE EKUIVALENTET E TYRE

Mjetet monetare në arkë dhe në bankë më 31 dhjetor 2018 janë si vijon:

| | **Më 31 dhjetor 2021** | **Më 31 dhjetor 2020** |
|---|---|---|
| Banka | 4,834,694 | 7,520,127 |
| Arka(Bileta sporti) | - | - |
| **Totali i mjeteve monetare dhe ekuivalenteve të tyre** | **4,834,694** | **7,520,127** |

Mjetet monetare në bankë përfshijnë llogarite rrjedhese ne leke, euro dhe usd me te cilat Shoqeria kryen pagesat si dhe arketon kerkesat nga te tretet.

## 5. TE DREJTA TE ARKETUESHME

Llogaria te drejta te arkëtueshme më 31 dhjetor 2021 përbëhen si vijon:

| | **Më 31 dhjetor 2021** | **Më 31 dhjetor 2020** |
|---|---|---|
| Kliente | 17,632,100 | 17,747,808 |
| Te tjera kerkesa te pagueshme(tatim fitimi | 3,465,558 | 3,465,558 |
| **TOTALI** | **21,097,695** | **21,213,365** |

Klientet perfaqesojne kerkesat per arketim per fatura të paarkëtuara per shumën 17,632,100 leke. Ne gjendjen e klienteve shuma prej 14,227,086 leke i takon klienteve te vjeter te cilet nuk kane mundesi arketimi. Gjithashtu jane perfshire 974 171 leke e cila perbehet nga vlera 647,985 leke kliente dhe 319,819 leke te tjera personel pa liste analitike para vitit 2011. Per kete detyrim shoqeria ka krijuar provizione per vitin 2021 nw shumen 2,736,500 leke te cilat jane njohur si shpenzim ne Pasqyren e Performances.
Gjithashtu rezulton dhe nje vlere tatim fitimi e mbipaguar per shumën 3,465,558 leke.

*(Shumat janë të shprehura në LEK, përveçse ku shprehet ndryshe)*

## 6. INVENTARI

Llogaria e inventarit eshte e perbere nga lende te para, materiale dhe inventar i imet gjendje ne fund te vitit.

| | Më 31 dhjetor 2021 | Më 31 dhjetor 2020 |
|---|---|---|
| Lende e pare materiale | 58,195 | 83,296 |
| Inventar i imet | 290,208 | 290,208 |
| **TOTALI** | **348,403** | **373,504** |

*(Shumat janë të shprehura në LEK, përveçse ku shprehet ndryshe)*

## 7. AKTIVET AFATGJATA MATERIALE

Aktivet afatgjata materiale më 31 dhjetor 2019 përbëhen si vijon:

Gjendja e Aktiveve te Qendrueshme ne date 31.12.2021

| | Toka | Ndertesa | Makineri Pajisje | Mjete transporti | **Totali** |
|---|---|---|---|---|---|
| ***Aktive te Trupezuara*** | | | | | |
| Gjendje 01.01.2021 | 515,124,090 | 149,732,791 | 9,078,235 | 2,397,920 | 676,333,035 |
| Shtesa | 0,00 | 0,00 | 100,000 | 0,00 | 100,000 |
| Pakesime | 0.00 | 0,00 | 382,600 | 0.00 | 382,600 |
| Gjendje 31.12.2021 | **515,124,090** | **149,732,791** | **8,795,635** | **2,397,920** | **676,050,435** |
| ***Amortizimi*** | | | | | |
| Gjendje ne 01.01.2021 | 0,00 | 66,493,188 | 7,734,792 | 1,997,722 | 76,225,702 |
| Shtesa llogaritur | 0,00 | 1,664,792 | 216,719 | 80,040 | 1,961,551 |
| Pakesime | 0.00 | 0,00 | 0.00 | 0,00 | 0.00 |
| Gjendje ne 31.12.20210 | **0,00** | **68,157,980** | **7,951,511** | **2,077,762** | **78,187,253** |
| ***Vlera neto 01.01.2021*** | 515,124,090 | 83,239,605 | 1,060,843 | 400,198 | 599,824,736 |
| ***Vlera neto 31.12.2021*** | **515,124,090** | **81,574,813** | **844,124** | **320,158** | **597,863,185** |

## 8.TË PAGUESHME PER SHPENZIME TE KONSTATUARA

Llogaria "Te pagueshme per shpenzime te konstatuara" perfaqeson detyrimet e shoqerise kundrejt furnitoreve te krijuar gjate vitit ushtrimor , detyrimet ndaj institucioneve shteterore si dhe detyrimet ndaj personelit

| | Më 31 dhjetor 2021 | Më 31 dhjetor 2020 |
|---|---|---|
| Furnitore | 222,400 | 529,440 |
| Tvsh per tu paguar | 181,717 | 124,312 |
| Sig.shoq dhe shendetesore | 244,926 | 208,661 |
| Tatim mbi te ardhurat personale | | |
| Tatim ne burim | 10,414 | 10,414 |
| Paga per tu paguar | 446,185 | 1,412,509 |
| **TOTALI** | **1,105,638** | **2,285,336** |

Të pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2021 përbëhen nga detyrimet kundrejt furnitoreve per faturat e papaguara per shumën 222,400 leke

Të pagueshme ndaj shtetit përmbajnë detyrimet për pagesen e tvsh-së së dhjetorit për shumën 181,717 leke, dhe tatimin në burim për shumën 10,414 leke.

Te pagueshme ndaj punonjesve permbajne detyrimet per pagat ndaj punonjesve per shumen 446,185 leke dhe detyrimet ndaj sigurimeve shoqerore dhe shendetesore per shumen 244.926 leke.

## 9.HUA FINANCIARE

Shoqeria ka marre nga Bashkia Tirane me date 14.10.2020 sipas nje kontrate te nenshkruar nje hua finaciare ne vleren 9 922 273 leke.

| | Më 31 dhjetor 2021 | Më 31 dhjetor 2020 |
|---|---|---|
| Hua Financiare nga Bashkia Tirane | 9,922,275 | 9,922,275 |
| **TOTALI** | **9,922,275** | **9,922,275** |

## 10.PROVIGJIONE AFATSHKURTRA

Shoqeria ka krijuar provizione per klientet gjate vitit 2021 nw shumwn 2,736,500 lekw.

*(Shumat janë të shprehura në LEK, përveçse ku shprehet ndryshe)*

| | Më 31 dhjetor 2020 | Më 31 dhjetor 2019 |
|---|---|---|
| Provizione | 15,194,890 | 12,458,390 |
| **TOTALI** | **15,194,890** | **12,458,390** |
| **DETYRIME AFATSHKURTERA** | **26,222,803** | **24,666,001** |

**11.DETYRIME AFATGJATA**

Llogaria detyrime afatgjata perfaqeson detyrimet ndaj njesive ekonomike brenda grupit (50% te te ardhurave per tu transferuar ne buxhet).

| | Më 31 dhjetor 2021 | Më 31 dhjetor 2020 |
|---|---|---|
